



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 86, datë 07.05.2018

PËR
MARRJEN E MASAVE NDAJ BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT PËR
MOSZBATIM TË VENDIMEVE TË BORDIT TË AUTORITETIT

Në bazë dhe për zbatim të neneve 31 dhe 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 14, 42 dhe 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit sipas pikës 2 të Vendimit nr. 217, datë 28.12.2017 “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2018”, ka urdhëruar Byronë Shqiptare të Sigurimit që të ndjekë procedurën e shlyerjes së menjëhershme të detyrimeve të papaguara të praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit, në vlerën e përgjithshme 923,354,758 lekë si për ngjarjet e sigurimit nga data 01.01.2001 deri në 31.12.2013 ashtu dhe për ato nga data 1 janar 2014 e në vazhdim. Në zbatim të këtij vendimi, BSHS duhet të fillonte shpërndarjen e këtyre praktikave duke autorizuar shoqëritë për pagesat e menjëhershme të tyre.

Autoriteti ka patur komunikime të vazhdueshme lidhur me zbatimin e pikës 2 të vendimit të Bordit nr. 217, datë 28.12.2017.

Në përgjigje të kërkesave të AMF-së, Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 1068 prot, datë 21.02.2018, informon se detyrimi për t’u shlyer është ndarë me vendimin e Asamblesë nr. 02 datë 23.01.2018 dhe procesi i pagesave do të bëhet mbi bazë çdo tremujori, siç përcaktohet mënyra e financimit të Fondit të Kompensimit në Rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit”.

Gjithashtu, BSHS me shkresën nr. 1819 prot, datë 29.03.2018, informon se ka shpërndarë praktika përmbartimore dhe gjyqësore në vlerën rreth 333,794,907 lekë dhe lëshuar autorizimet për pagesat e tyre.

Referuar raportimit periodik të BSHS-së, për periudhën janar-31 mars 2018, depozituar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 2035, prot, datë 13.04.2018, informohemi se

pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit të kryera gjatë kësaj periudhe për dëmet pezull deri më datë 31.12.2013, janë në vlerën **165,899,400** lekë, ndërsa për dëmet pas datës 1 janar 2014 e në vazhdim në vlerën **43,244,057** lekë.

Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 218, datë 28.12.2017, ka urdhëruar Byronë Shqiptare të Sigurimit që brenda datës 31.01.2018, të procedojë me përzgjedhjen e shoqërisë ndërkombëtare të auditimit me qëllim auditimin e veprimtarisë së BSHS që lidhet me detyrimet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit.

Ky vendim e detyron BSHS-në, që të njoftojë Autoritetin për përzgjedhjen e kësaj shoqërie, brenda 3 ditëve nga data e përzgjedhjes.

BSHS informon me shkresën nr. 1819 prot, datë 29.03.2018, se ka kontaktuar me shoqëri auditimi. Shoqëria audituese ende nuk është përzgjedhur pasi po përfundon sistemi elektronik i dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit me të gjitha të dhënat dhe përzgjedhja e audituesit do të bëhet pas përfundimit të këtij procesi.

Siç konstatohet më sipër, Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk ka zbatuar vendimet e Autoritetit nr. 217 dhe 218, datë 28.12.2017.

Përsa më sipër, referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, në funksion të mbikëqyrjes së BSHS-së, në funksion të misionit të AMF-së për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve si dhe problematikave ndër vite në tregun e sigurimeve që lidhen me Fondin e Kompensimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 31, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, të sanksionohet me gjobë në masën 75,000 lekë, Drejtori Ekzekutiv i Komanduar i BSHS-së, për moszbatim të vendimeve të Autoritetit.
2. Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda datës 15 maj 2018, të bëjë shpërndarjen e praktikave në zbatim të pikës 2 të vendimit të Bordit nr. 217, datë 28.12.2017, duke autorizuar shoqëritë e sigurimit, që më pas të vijojnë me procesin e pagesave.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda datës 15 maj 2018, të përzgjedhë shoqërinë audituese, në zbatim të vendimit të Bordit nr. 218, datë 28.12.2017.
4. Nëse Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk zbaton pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, Autoriteti do të vijojë me masat e përshkallëzuara të parashikuara në legjislacionet në fuqi.
5. Ngarkohen departamentet përkatëse për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI